

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AGROCON ALBANIA SH.P.K
RRUGA "QENDËR", NDËRTESE PRIVATE, ZK 2790, NR.PASURIE 153, FSHATI "NGRURRËS I VOGËL",
KRUTJE, FIER
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
K722080140

VENDIM NR. 8

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 13.11.2019, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **AGROCON ALBANIA Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Është e pranishme shoqëria "**Balfin**" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NIPT/NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë (më tej referuar si "**Ortaku i Vetëm**"), e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE

- I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TE KAPITELIT NËPËRMJET KAPITALIZMIT TE PJESSHME TE HUASE DHE KONTRIBUTIT TE ORTAKUT TE VETËM.**
- II. TË NDRYSHME.**

- I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TE KAPITALIT NËPËRMJET KAPITALIZMIT TE PJESSHËM TE HUASE DHE KONTRIBUTIT TE ORTAKU I VETËM.**

Në lidhje me pikën e parë, Kryetari i Asamblesë parashtron se Ortaku i Vetëm, Shoqëria Balfin Sh.p.k.' vlerëson me përparësi që një pjesë e vlerës së huas dhe kontributit që i është dhënë ndër vite Shoqërisë me qëllim përballin e shpenzimeve dhe investimeve për aktivitetin e saj të kalohet në kapitalin e Shoqërisë duke zmadhuar vlerën e këtij të fundit.

Konkretisht, Kryetari sqaron se shuma me të cilën do të zmadhohet kapitali aktual i Shoqërisë është **152,969,234 Lek (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nënte mije e dyqind e tridhjetë e katër leke)** e cila konkretisht përbehet nga:

- **Shuma prej 138,694,884 Lek (njëqind e tridhjetë e tete milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mije e tetëqind e tetëdhjetë e katër leke)** përbehet nga kontribute/fonde që i janë kaluar Shoqërisë sipas tabelës me poshtë:



DATE	VLERA NË EUR	KURSI KËMBIMIT	KUNDËRVLERA NË LEKË
KONTRIBUTI NE EURO			
03/10/2019	60,000	122.66	7,359,600
01/11/2019	65,445	123.19	8,027,484
12/11/2019	830,000	122.88	101,807,800
TOTALI NE EURO	955,445	KUNDËRVLERA NE LEK TOTAL	117,194,884
KONTRIBUTI NE LEKE			
01/11/2019	N/A	N/A	17,916,143
12/11/2019	N/A	N/A	3,583,857
KONTRIBUTI TOTAL NE LEKE			138,694,884

- **Shuma prej 14.274.350 Lek (katërbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë leke)** e cila është pjesë e detyrimit të Shoqërisë kundrejt Ortakut që buron nga Marrëveshja e Financimit datë 30.06.2017, e ndryshuar, ku Ortaku i Vetëm në cilësinë e Huadhënësit ka pranuar të japë në favor të Agrocon Albania Sh.p.k., në cilësinë e Huamarrësit një hua me interes vjetor 2% në shumën e përgjithshme (i) **2,371,163 EUR (dy milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre euro); dhe (ii) 33,841,480 LEK (tridhjetë e tre milion e tetëqind e dyzetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë lekë)** (në vijim quajtur edhe "Huaja").

Per rrjedhim të sa më sipër propozohet që kapitali i Shoqërisë aktualisht në vlerën 203,310,000 Lek (dyqind e tre milion e treqind e dhjetë mijë leke) të zmadhohet me 152,969,234 Lek (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke), për një kapital në një vlerë totale prej 356,279,234 Lek (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke)

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të çështjes së Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë:

VENDOSI:

A. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet:

- (i) kapitalizimit të vlerës së pjesës së pashlyer të Huasë së dhënë nga Ortaku i Vetëm në favor të këtij të fundit sipas Marrëveshjes së Financimit datë 30.06.2017 (të ndryshuar) në shumën **14.274.350 Lek (katërbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë leke)**
dhe
- (ii) Kapitalizimit të kontributeve/fondeve që i janë kaluar Shoqërisë nga Ortaku i Vetëm **138,694,884 Lek (njëqind e tridhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër leke)**

Per një total prej 152,969,234 Lek (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke), ("Zmadhimi i Kapitalit").

B. Bazuar në sa më sipër Zmadhimi i Kapitalit do të konsiderohet i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm.


C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, Kapitali i Shoqërisë, nga 203.310.000 Leke (dyqind e tre milion e treqind e dhjetë mijë leke) do të bëhet në shumën **356,279,234 Lek (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër leke)**




- D. Te autorizojë z. Florian Lama, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë procedurat e regjistrimit të sipër përmendura, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Administratori ka të drejtë të emërojë sipas gjykimit dhe pëlqimit të tij çdo person të tretë për të ndjekur dhe kryer procedurat e regjistrimit të shoqërisë së re pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe çdo organi tjetër shtetëror e publik ku regjistrimi është i nevojshëm e i kërkuar me ligj.

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
AGROCON ALBANIA SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira Muka

SEKRETARI


Z. Bers Hado

